



EKONOMIA DHE FINANCAT PAS BLOKIMIT NGA COVID-19

Masat shtrënguese në zbatim, që kanë vendosur në karantinë shumë shtete në Evropë dhe në botë kanë “izoluar” tregtinë, si rrjedhojë eksporti rezulton si tronditja e parë në ekonomi. COVID-19 është ndikuesi kryesor i kësaj krize, duke nënkuptuar sakrificat të konsiderueshme për sa i përket mbajtjes së ekonomisë në nivele pranë zeros. Aktualisht mbi 50% e PBB-së globale (dhe popullsia) është izoluar njëkohësisht, duke krijuar kështu efekte të rënda edhe për marrëdhëniet tregtare të Shqipërisë me vendet partnere të rëndësishme, si: Greqia, Italia apo Gjermania, etj.

Oferta monetare sinjalizon kushte shumë të forta financiare për bizneset. Ndalja e papritur në qarkullimin fizik të njerëzve, mallrave, shërbimeve dhe parave janë sfidat që ky bllokim paraqet për efektivitetin e politikës monetare. Stabiliteti financiar tashmë është duke ri-hyrë në terrene që vazhdojnë të lëkundën.

Qeveria shqiptare është përqendruar në zbutjen e ashpërsisë

së krizës së rrjedhës së parave (likuiditetit). Politikat fiskale që u deklaruan dhe janë miratuar janë adresuar për të: (i) zbutur presionet e fluksit të parave të bizneseve përmes linjave të kreditit me garanci sovraane, si dhe shtyrjen e shpenzimeve të taksapaguesve ndaj buxhetit dhe shoqërive publike (taksat, kamatat për energjinë e papaguar në kohë, shërbime të ndryshme, etj.), si dhe (ii) mbështetjen e të ardhurave të familjeve duke forcuar sigurinë shoqërore dhe zbatimin e subvencioneve të të ardhurave.

Institucionet publike po vijojnë mbështetjen për familjet, firmat dhe tregun e punës.

Politika monetare ka filluar të lëvizë nga normaliteti rutinor i saj duke tentuar masa të jashtëzakonshme dhe ulje të normës bazë të interesit. Masat fiskale dhe ato monetare duan të lehtësojnë valën goditëse të recesionit.

Ndërsa kjo është thelbësore për një rikuperim të fortë, ekziston një pasiguri e konsiderueshme në lidhje me atë se si do të duket panorama ekonomike kur të dalim nga ky bllokim.

Humbja e punës do të ndikojë në veçanti punëtorët me kontrata të përkohshme, si dhe të vetë-punësuarit. Vendet me hapësirë të kufizuar fiskale, ashtu si edhe Shqipëria do të kërkojnë ndihmë nga FMN dhe Banka Botërore, të cilat nga ana e tyre kanë njoftuar se do të qëndrojnë të gatshme me mbështetje për vendet e goditura nga COVID-19.

Po kështu Këshilli i Evropës ka ofruar kredi të butë prej 180 milion euro për kufizimin e pasojave ekonomike nga COVID-19.

Duke konsideruar peshën e madhe të punësimit që ka sektori i eksportit, një stimulim tjetër i drejtpërdrejt në zinxhirin e ekonomisë duhet t'i ofrohet eksportit.

Duke mos qenë një ekonomi e industrializuar, por më shumë një ekonomi e bazuar tek tregtia dhe shërbimet, natyrisht që bllokimi aktual i ekonomisë nuk do të japë ato efekte që diskutojnë ekspertët e ekonomisë dhe financave për vendet e zhvilluara dhe kjo patjetër një bonus për Shqipërinë.

Kur bëhet fjalë për rimëkëmbjen e ekonomisë, qeveria ka në dispozicion dy mjete kryesore: stimulin monetar dhe stimulin fiskal. Edhe pse këto qasje nuk janë opsionet e vetme, që mund të zbatohet një qeveri e përkushtuar, në realitet shumica e paketave të ndihmës ekonomike në vende të ndryshme janë duke u orientuar në këto dy kategori.

Stimulimi fiskal nëse ndiqet në praktikë sipas një koordinimi të politikave monetare dhe fiskale mund të zëvendësojë aktivitetin e biznesit të humbur gjatë kësaj krize shëndetësore komplekse. Nëse funksionon, qeveria vazhdon shpenzon derisa konsumatorët të rimarrin besimin e mjaftueshëm dhe fuqia e shpenzimit të mbështesë kërkesën pa ndërhyrje.

Pra, zgjidhja e një logjike financiare dhe program i rimëkëmbjes është i vlefshëm, sepse ndihmon krahun e kërkesës konsumatorë duke ndihmuar direkt bizneset dhe punësimin e njerëzve. Por nga ana tjetër një ndërhyrje në bilancet e sektorit privat (qoftë kjo edhe me rastin e amnistisë së shpallur), do të ndikonte pozitivisht në problematikat e ndryshme juridiko-financiare të mbartura.

Bashkëpunimet shumëpalëshe efektive midis qeverisë, shoqërisë civile dhe sektorit privat është vital për shëndetin ekonomik dhe rimëkëmbjen e vendit.

NGA EDUART GJOKUTAJ - EKSPERT PRANË ALTAX